

Nr. \_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra****PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)  
OBJEKTI I PROCEDURËS: “F.V Pajisje IT (Laptop dhe sistem videokonference)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): *Kompjutera portativ 30213100-6, Pajisje video-konferencash 32232000-8, Televizion interaktivë 92225000-4*

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **7,000,000 (shtatë milion) Lekë pa TVSH.**

**Burimi i financimit:** Të ardhurat e AK Banka Shqiptare e Zhvillimit sha

**Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër ose afati i zbatimit të kontratës:** 45 ditë kalendarike nga lidhja e kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Banka Shqiptare e Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

**I. Artikujt, sasitë përkatëse dhe koha e lëvrimit e pritshme**

| Artikulli | Përshkrimi                                         | Sasia/Copë | Destinacioni | Periudha e dorëzimit                        |
|-----------|----------------------------------------------------|------------|--------------|---------------------------------------------|
| 1         | F.V Laptop i avancuar                              | 55         | BZH          | 45 ditë kalendarike nga lidhja e kontratës. |
| 2         | F.V Ekran Interaktiv 65"                           | 1          | BZH          | 45 ditë kalendarike nga lidhja e kontratës. |
| 3         | F.V Sistem Audio/Video Bar për Sallën e Mbledhjeve | 1          | BZH          | 45 ditë kalendarike nga lidhja e kontratës. |

**Shënime:**

i **Afatet e lëvrimit: 45 ditë kalendarike nga lidhja e kontratës.**

- ii Transportin do ta kryejë operatori ekonomik fitues.
- iii Instalimi, konfigurimi dhe vendosja në gjendje pune është përgjegjësi e operatorit ekonomik fitues dhe do të realizohet nën urdhëzimin dhe mbikëqyrjen e përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktor.

## II. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË ARTIKUJVE

### LAPTOP i avancuar

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE PËR LAPTOP                    |                                                                                                                                                                                                                          |
|---------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Karakteristika                                                | i Avancuar                                                                                                                                                                                                               |
| <b>Pikët Minimale për procesorin sipas: cpubenchmark.net:</b> | 12200 Pikë                                                                                                                                                                                                               |
| <b>Procesori:</b>                                             | Procesor i klasës biznesi/enterprise, minimum 8 bërthama (cores), lançuar zyrtarisht nga prodhuesi (Intel/AMD) brenda 24 muajve para datës së hapjes së ofertave, me rezultat minimum 12,200 pikë sipas cpubenchmark.net |
| <b>“RAM”:</b>                                                 | minimum 16GB RAM dual-channel, DDR4 3200MHz ose DDR5 ose ekuivalent i gjeneratës së re                                                                                                                                   |
| <b>Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:</b>               | minimum 512GB SSD NVMe PCIe                                                                                                                                                                                              |
| <b>“Graphics”:</b>                                            | GPU: e integruar me CPU, me mbështetje për rezolucion minimum 1920×1080 dhe dalje video të jashtme                                                                                                                       |
| <b>Ekrani “Display”:</b>                                      | Minimumi 15.6" FHD (1920×1080) IPS ose ekuivalent, Anti-Glare, minimum 300 nits, minimum 60Hz, minimum 72% sRGB                                                                                                          |
| <b>Bateria “Battery”:</b>                                     | minimum 56Wh, autonomi minimale 4 orë në përdorim tipik zyre                                                                                                                                                             |
| <b>Pesha</b>                                                  | jo më shumë se 2 kg                                                                                                                                                                                                      |
| <b>“Web Camera”:</b>                                          | minimum 1080p FHD Camera e integruar, me mikrofon të integruar dhe noise cancellation, me privacy shutter fizik ose ekuivalent elektronik                                                                                |
| KOMUNIKIMI & MENAXHIMI                                        |                                                                                                                                                                                                                          |
| <b>Portat e komunikimit “Ports”:</b>                          | <i>Minimumi (1) USB Type-C me mbështetje për Power Delivery (PD) dhe DisplayPort Alt Mode</i>                                                                                                                            |
|                                                               | <i>(2) USB 3.1 Type-A (minimum 5Gbps)</i>                                                                                                                                                                                |
|                                                               | <i>Minimum (1) HDMI 2.0 minimum</i>                                                                                                                                                                                      |
|                                                               | <i>Minimumi (1) RJ45 Gigabit Ethernet</i>                                                                                                                                                                                |
|                                                               | <i>Mikrofon i integruar me noise cancellation</i>                                                                                                                                                                        |
| <b>Rrjeti “Networking”:</b>                                   | <i>Webcam e integruar minimum 1080p FHD me privacy shutter</i>                                                                                                                                                           |
|                                                               | <i>Headphone/Microphone Jack ose ComboJack</i>                                                                                                                                                                           |
| <b>Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S”:</b>        | 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45);                                                                                                                                                                                            |
|                                                               | minimum 802.11ax (Wi-Fi 6), kompatibël me 802.11b/g/n/ac; minimum Bluetooth 5.0;                                                                                                                                         |
| <b>Tastiera “Keyboard”:</b>                                   | OEM Windows 11 64-bit Professional, i parainstaluar dhe i licensuar, me të gjithë drajverët e përditësuar në momentin e dorëzimit, Recovery Partition e integruar                                                        |
|                                                               | QWERTY Layout US/EU, me ndriçim (backlit), rezistente ndaj derdhjes së lëngjeve (spill-resistant), me tastierë numerike (numpad) të integruar                                                                            |

|                                       |                                                                                                                                                                                                               |
|---------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>“Sound”:</b>                       | Minimumi 2 altoparlantë të integruar, minimum 2W secili, me mbështetje për noise cancellation dhe echo reduction për videokonferenca                                                                          |
| <b>“Pointing Device”:</b>             | Touchpad i integruar me mbështetje për gjeste shumëgishërore (multi-touch gestures), i saktë dhe i përgjegjshëm, kompatibël me Windows 11                                                                     |
| <b>Siguria “Security Management”:</b> | Trusted Platform Module TPM 2.0, Secure Boot i aktivizueshëm, mbështetje për disk encryption (BitLocker ose ekuivalent), procesor me teknologji menaxhimi në distancë (Intel vPro ose AMD PRO ose ekuivalent) |
| <b>AKSESORËT</b>                      |                                                                                                                                                                                                               |
| <b>Kabëll, Karikues</b>               | Karikues origjinal me kablo furnizimi me spinë evropiane (Type C/F, 220-240V, 50Hz, i përshtatshëm për rrjetin elektrik shqiptar)                                                                             |
| <b>“Mouse”:</b>                       | Po, i të njëjtës Markë me Laptopin ose ekuivalent i cilësisë së njëjtë, me kabëll, minimumi 1600 DPI, ngjyra neutrale (e zeze/gri)                                                                            |
| <b>Çanta “Carrying Bag”:</b>          | Po, nga Prodhuuesi ose ekuivalent i cilësisë së njëjtë. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë                                                                                                       |
| <b>“Recover”:</b>                     | Recover Partition                                                                                                                                                                                             |
| <b>GARANCIA</b>                       |                                                                                                                                                                                                               |
| <b>Periudha e Garancisë:</b>          | 3 vjet                                                                                                                                                                                                        |

### **Ekran Interaktiv 65”**

| <b>KARAKTERISTIKA PER EKRAN INTERAKTIV 65”</b> |                                                                                                                                                                                                                                                               |
|------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Karakteristika</b>                          | <b>Specifikim</b>                                                                                                                                                                                                                                             |
| <b>Lloji i pajisjes</b>                        | Ekran interaktiv me prekje (interactive flat panel) për sallë mbledhjesh, për prezantime, shfaqje video-konference dhe shënime/whiteboard dixhital. Pa kërkesë për kamerë/mikrofon/altoparlantë të integruar (të mbuluara nga sistemi audio/video i veçantë). |
| <b>Madhësia e ekranit</b>                      | Minimumi 65"                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Rezolucioni</b>                             | 4K UHD (3840×2160) ose më lart                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Formati i ekranit</b>                       | 16:9                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <b>Frekuenca e rifreskimit</b>                 | Minimumi 60 Hz                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Ndriçimi</b>                                | Minimumi 350 nits, xham anti-reflektues (anti-glare)                                                                                                                                                                                                          |
| <b>Këndi i shikimit</b>                        | Minimumi 178° horizontal/vertikal                                                                                                                                                                                                                             |
| <b>Teknologjia e prekjes</b>                   | Prekje kapacitive (capacitive touch), minimum 20 pika prekjeje njëkohësisht, me mbështetje për shënim me gisht dhe stilolaps (stylus), palm-rejection (injoinim i pëllëmbës gjatë shkrimit)                                                                   |
| <b>Xhami/Rezistenca</b>                        | Xham i fortësuar (tempered glass), rezistent ndaj gërvishetjeve, minimumi 4mm trashësi                                                                                                                                                                        |
| <b>Sistemi/OS</b>                              | Sistem operativ i integruar (Android ose ekuivalent) për funksione whiteboard/shënime pa kërkuar PC të jashtëm; opsion i preferuar: slot i brendshëm (OPS ose ekuivalent) për module kompjuterike Windows shtesë                                              |
| <b>Software Whiteboard</b>                     | Aplikacion i integruar për shënime dixhitale, ruajtje/eksportim (PDF, imazh), dhe ndarje ekrani (screen mirroring/cast) me/pa kablo                                                                                                                           |

|                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Portat</b>                                                                                                                        | Minimumi: 2× HDMI IN, 1× HDMI OUT (loop-through), 1× USB-C (me video + Power Delivery min 65W), minimum 3× USB-A, RJ45 Gigabit LAN, Wi-Fi minimum 802.11ac (Wi-Fi 5) ose më i ri, Bluetooth 5.0                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>Jetëgjatësia/Përdorimi</b>                                                                                                        | I klasës komerciale, i projektuar për funksionim minimum 16 orë/ditë, 7 ditë/javë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>Montimi</b>                                                                                                                       | Ekrani të vijë i pajisur me standë lëvizëse (mobile floor stand) me rrota, të përfshirë tërësisht në ofertën ekonomike. Stenda të ketë: rrota me fren (lockable castors) për stabilitet kur është e palëvizshme, bazë e gjerë antitip (anti-rrëzim), lartësi e rregullueshme (manuale ose motorike/elektrike), kapacitet mbajtës minimum 80 kg, e përputhshme me standardin VESA të ekranit (400×400 deri 600×400mm), me menaxhim/fshehje kabllosh të integruar. Instalimi, montimi dhe testimi final të përfshihen nga furnizuesi. |
| <b>Certifikimet</b>                                                                                                                  | CE, RoHS, FCC ose ekuivalent                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>Aksesorët</b>                                                                                                                     | Kablllo energjie me spinë evropiane (Type C/F), telekomandë, suport VESA ose ekuivalent i përfshirë, 1 copë kablllo HDMI 2.0 minimumi 2 metra, 1 copë Kablllo HDMI 2.0 minimumi 5 metra (për distancë më të madhe në sallë), fishe USB                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>Produkti të jetë i ri, jo refurbished</b>                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>Garancia - minimale 3 vjet me riparim ose zëvendësim pajisje në rast defekti hardware sipas praktikës standarte të prodhuesit</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |

## Sistem Audio/Video Bar për Sallën e Mbledhjeve

| <b>KARAKTERISTIKA PER SISTEM AUDIO/VIDEO BAR</b>                                                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Karakteristika                                                                                                                       | Specifikim                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>Përshkrimi i përgjithshëm</b>                                                                                                     | Sistem gjithëpërfshirës audio/video për sallë mbledhjesh, i integruar në një njësi të vetme (all-in-one bar), që kombinon kamerë, mikrofoni dhe altoparlantë. I pajtueshëm me Microsoft Teams dhe platforma të tjera kryesore të videokonferencave.                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Kamera</b>                                                                                                                        | Rezolucion minimum 1080p FHD, fushëpamje e gjerë (minimum 90° FOV), me inkuadrim automatik (auto-framing) për ndjekjen e folësit, zoom optik ose dixhital minimum 3×                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>Mikrofoni</b>                                                                                                                     | Grup mikrofonesh të integruar me anulim jehone (echo cancellation) dhe reduktim zhurme (noise reduction), mbulim 180° i sallës, distancë minimale kapjeje 4-5 metra                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Altoparlantët</b>                                                                                                                 | Altoparlantë të integruar, minimum 2×10W, cilësi audio e përshtatshme për komunikim të qartë në sallë mbledhjesh                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>Lidhja</b>                                                                                                                        | Minimum 2 porta USB (USB-A ose USB-C) për lidhje me laptop dhe pajisje periferike, Ethernet RJ45 (opsional i preferuar për stabilitet), Wi-Fi opsional                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>Kompatibiliteti</b>                                                                                                               | Kompatibel me Microsoft Teams, Zoom, Google Meet dhe platforma të tjera ekuivalente kryesore të videokonferencave. Plug & Play pa softuer shtesë të detyrueshëm.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>Montimi</b>                                                                                                                       | Bar-i audio/video të montohet direkt mbi kornizën (bezel) e ekranit interaktiv, sipër ose poshtë tij (under/over display mount), pavarësisht nëse ekrani është i montuar në mur ose në stendë lëvizëse. Kit-i i montimit të jetë i përshtatshëm/universal për t'u fiksuar te korniza e ekranit (jo vetëm te muri ose stenda veçmas), në mënyrë që bar-i të lëvizë bashkë me ekranin nëse ky i fundit zhvendoset. Të përfshihen të gjitha fishat, fishat USB plus 1 fishë shtesë rezervë, kabllimi i nevojshëm tavoline si dhe instalim e konfigurim. |
| <b>Certifikimet</b>                                                                                                                  | Microsoft Teams Certified ose ekuivalent, CE, RoHS, FCC ose ekuivalent                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>Furnizimi me energji</b>                                                                                                          | Furnizim me energji 220-240V AC, 50Hz me spinë evropiane (Type C/F)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Produkti të jetë i ri, jo refurbished</b>                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <b>Garancia - minimale 3 vjet me riparim ose zëvendësim pajisje në rast defekti hardware sipas praktikës standarte të prodhuesit</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |

### III. Argumentimi i specifikimeve teknike dhe sasiore:

Specifikimet teknike janë hartuar nga strukture e specializuar, konkretisht komisioni për objektin që do të prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” (LPP), si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit

*publik*”, duke argumentuar çdo specifikimet teknike, treguesit sasiore, kërkesat funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë në markë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

#### **Argumentimi, mbi nevojën:**

Referuar memon për prokurimin e pajisjeve IT Nr.181., datë 10.07.2026 të specialistit të logjistikës dhe aprovuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe shënimit të Titullarit në memon Nr.121/19 datë 26.08.2026 mbi urgjencën e prokurimit të laptopëve dhe sistemit të videokonferencës dhe në bazë të Urdhërit Nr.101 datë 08.09.2026, Komisioni procedoi me hartimin e specifikimeve teknike për 3 (tre) zëra, të cilët rezultojnë që duhen prokuruar me urgjencë, nisur nga fakti që aktualisht Banka Shqiptare e Zhvillimit ka punonjës të punësuar të cilët duhet që të furnizohen me mjete pune, laptopë. Ndërkohë, duke qenë se së shpejti Banka Shqiptare e Zhvillimit së bashku me konsorciumin ndërkombëtar të konsulentëve do të nisë hartimin e strategjisë, planit të biznesit dhe strukturimin operacional, rezulton e nevojshme që të prokurohen laptopët si pajisjet bazë për përpunimin dokumentar dhe sistemi i videokonferencës për mbajtjen e takimeve, mbledhjeve dhe diskutimeve ndërmjet palëve të përfshira direkt në këtë proces si ekipi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit, Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Mbikëqyrës dhe konsorciumi i konsulentëve.

#### **IV. KRITERET E KAPACITETIT TEKNIK**

Komisioni për hartimin e specifikimeve dhe kriterëve të kapacitetit teknik, vijoi me përcaktimin e kriterëve të kapacitetit teknik, si një masë e nevojshme për të garantuar furnizimin dhe vendosjen në gjendje pune të pajisjeve dhe artikujve objekt prokurimi.

Duke qenë se objekti i prokurimit do të furnizohet dhe vendoset në gjendje pune nga operatori ekonomik fitues, është e nevojshme që Autoriteti Kontraktor të garantohet paraprakisht për aftësinë zbatuese dhe disponimin e burimeve njerëzore të kualifikuara nga operatori ekonomik.

Në këtëv kuptim, kriteret e kapacitetit teknik janë si vijon:

**2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:**

a) Standartin ISO 9001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim distributori ku të autorizohet për shitjen e mallrave në zërin 1 (Laptop i avancuar). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/email/ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë (në mënyrë elektronike, në sistemin e APP-së) katalogun/et ose fragmente (faqe) të katalogut/eve për mallrat objekt prokurimi në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet teknike të dokumentave të tenderit të autoritetit kontraktor me ato të ofertuara nga operatori ekonomik. Kataloget të cilët nuk janë në gjuhën shqipe duhet të paraqiten të përkthyer dhe te noterizuar.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme me të dhënat e kërkuara:

| Nr. | Emërtimi i Mallit                              | Modeli i pajisjes se ofertuar | Kompania prodhuese |
|-----|------------------------------------------------|-------------------------------|--------------------|
| 10  | Laptop i avancuar                              |                               |                    |
| 19  | Ekran Interaktiv 65"                           |                               |                    |
| 20  | Sistem Audio/Video Bar për Sallën e Mbledhjeve |                               |                    |

## V. ARGUMENTIMI TEKNIK I KRITEREVE TË KAPACITETIT TEKNIK

Grupi i punës argumenton se kriteret e kapacitetit teknik i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu garantuar paraprakisht për aftësinë zbatuese dhe disponimin e burimeve njerëzore të kualifikuara nga operatori ekonomik.

1. Konkretisht, në lidhje me kriterin:

*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:*

a) Standartin ISO 9001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

2. Në lidhje me kriterin: *“Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim distributori ku të autorizohet për shitjen e mallrave në zërin 1 (Laptop i avancuar). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/email/ëbbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.”*

Argumentimi: Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për artikullin Laptop, duke qenë se është zëri me peshëm më të madhe në të gjithë objektin e prokurimit, prandaj mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokurimit, kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar për elemente të rëndësishëm dhe thelbësorë të kontratës, shërben si garanci në çfarëdo rasti anomalie përgjatë afatit të implementimit të kontratës, si dhe garanton aktivizimin ad hoc të shërbimeve të prodhuesit, sic janë ato të suportit dhe mbështetjes teknike e administrative.

Referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi për Laptopët, si pjesa më determinante e objektit të kontratës, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues.

Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë monitoruese të pajisjeve, dhe nevojës për garanci mbi efikasitetin dhe kapacitetet teknike të pajisjeve.

3. Në lidhje me kriterin: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë (në mënyrë elektronike, në sistemin e APP-së) katalogun/et ose fragmente (faqe) të katalogut/eve për mallrat objekt prokurimi në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet teknike të dokumentave të tenderit të autoritetit kontraktor me ato te ofertuara nga operatori ekonomik. Kataloget të cilët nuk janë në gjuhën shqipe duhet të paraqiten të përkthyer dhe te noterizuar.

Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme me të dhënat e kërkuara:

| Nr. | Emërtimi i Mallit                              | Modeli i pajisjes se ofertuar | Kompania prodhuese |
|-----|------------------------------------------------|-------------------------------|--------------------|
| 1   | Laptop i avancuar                              |                               |                    |
| 2   | Ekran Interaktiv 65"                           |                               |                    |
| 3   | Sistem Audio/Video Bar për Sallën e Mbledhjeve |                               |                    |

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, dhe në mbështetje të pikës 6 gërma b) të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar .Katalogu është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike.

4. Në lidhje me kriterin: “ Për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, për të realizuar instalimet dhe konfigurimet e kërkuara si dhe për të garantuar suportin dhe garancinë përgjatë periudhës së parashikuar sipas specifikimeve teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë minimalisht punonjës të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (nje) specialist per Sistem Konference te certifikuar nga prodhuesi e markes se ofertuar ose ekuivalent.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur edhe nëse një punonjës zotëron më shumë se një certifikatë/kualifikim.**

*Për punonjesit e mesiperm, operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- i *Listëpagesën sipas formularit e Sig25 për për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit;*
- ii *Certifikatën ose dëshminë e kualifikimit.”*

Argumentimi: Kërkesa është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 40, pika 5:

*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*“ 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. ”*

*“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si me lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmerinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

Konkretisht, kërkesa për të paktën 1 (një) specialist për Sistem Konferencë të certifikuar nga prodhuesi i markës së ofertuar ose ekuivalent, argumentohet me nevojën e AK për të patur asistencë nga operatori ekonomik në lidhje me procedurën e instalimit dhe vënies në punë të sistemit të videokonferencës duke qenë se ky sistem duhet të lidhet me ekranin dhe/ose pajisje të tjera si laptop dhe gjithashtu duhet të instalohet në njësinë e vet mbajtëse.

Duke qenë se është një sistem i cili ka edhe komponentë audio dhe video, duhet një specialist i certifikuar për instalimin e sistemeve të videokonferencës.

Ndërkohë, njësia e prokurimit argumenton ligjërisht kriteret si më poshtë:

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4, në vlerë 140,000 (njëqind e dyzet mijë) Lekë.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9. *(për secilin lot)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- 1.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), në vlerë sa 39% të fondit limit të procedurës së prokurimit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur

nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, fond i cili është nën kufirin e ulët monetar dhe zbatohen përcaktimet e nenit 49 të LPP dhe 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Konkretisht vlera e xhiros së kërkuar është mbështetur në pikën 4 të nenit 55 dhe nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP të ndryshuar.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % e fondit limit të procedurës së prokurimit ose 1,330,000 (një milion e treqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH, të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, lloji i mallrave dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe në nenin 55, pika 4, shkronja b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Grupi i punës argumenton se kriteret e kapacitetit teknik i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu garantuar paraprakisht për aftësinë zbatuese dhe disponimin e burimeve njerëzore të kualifikuara nga operatori ekonomik.

Ndërkohë njësia e prokurimit, i gjen të bazuara në LPP dhe RrPP kërkesat teknike të nëposhtme.

**2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:**

**ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë ” (e vlefshme) ose ekuivalent;**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Si dhe mbështetur në nenin 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

## **VI. Mbi procedurën e anuluar të prokurimit**

Në zbatim të nenit 93, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit: “3. Autoriteti/enti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që çuan në dështimin e procedurës dhe, nëse është rasti, i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës. Ky proces dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim, nga njësia e prokurimit.”, Njësia e prokurimit ka analizuar shkaqet e anulimit të procedurës së prokurimit.

Referuar pikës 9 të Njoftimit të Shkurtuar të Kontratës, pjesë e DST, rezulton se:

### **9. Procedurë e Rishpallur:**

| Po | X | Jo | d |
|----|---|----|---|
|----|---|----|---|

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit:  
**REF-94168-07-22-2026**

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit: **“F.V Pajisje elektronike për nevoja të Bankës Shqiptare të Zhvillimit sha”**

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit: **13,000,000 (trembëdhjetë milion) lek pa TVSH.**

Procedura e prokurimit është rishpallur pas anulimit të procedurës me të dhënat e sipërcituara.

Në referim të njoftimit të anulimit, konstatohet se shkaqet e anulimit janë sepse AK nuk ka identifikuar asnjë ofertë të përshtatshme të paraqitur, pasi nga 3 (tre) ofertat e paraqitura, Komisioni I Vlerësimit të Ofertave nuk gjeti asnjë ofertë e cila të jetë plotësisht 100 % në përputhje me parashikimet në Dokumentat Standarte të Tenderit.